REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria Kosovës / Vlada Kosovo / Government of Kosovo
Ministria e Financave dhe Transfereve/ Ministarstvo za Finansije i Transfere
Ministry of Finance and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosovo / Tax Administration of Kosovo
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE
Njësia Org. Org.Jedin. Org. unit: Z.9
Nr. Prot. Br. Prot. No: 09.06.71
Nr. Faqeve Broj stranica No papers:
Data Datum Date: 10/01/23
01 HYRËSE PRISHTINË/A

Duke pasur parasysh dispozitat e Ligjit Nr.05/L-087 për Kundërvajtje si dhe në harmoni me dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurat e Përgjithshme Administrative, në mbështetje të dispozitave sipas Ligjit bazik Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe Nr. 04/L-223 si dhe aktet nënligjore që derivojnë nga ky Ligj, në funksion të përmbushjes së rekomandimit sipas Raportit Ex officio nr. 412/2022 të Avokatit të Popullit, Drejtori i Ekzekutiv i Administratës Tatimore të Kosovës, miraton këtë:

RREGULLORE E BRENDSHME ATK/NR. 01/2023

PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME ATK/NR. 01/2022 MBI PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR FUNKSIONIMIN E NJËSIVE ORGANIZATIVE PËR GJOBA DHE NDËSHKIME (ZGJONA)

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim ndryshim plotësimin e Rregullores së Brendshme ATK/Nr. 01/2022 mbi përcaktimin e procedurave për funksionimin e njësive organizative për Gjoba dhe Ndëshkime(ZGJONA)

Neni 2

Tek neni 12 i Rregullores bazë, ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 3, me tekstin si në vijim:

3. *Në dispozitiv të Vendimit duhet të përcaktohet qartë se në rast të pagimit të gjobës së shqiptuar brenda afatit prej pesëmbëdhjetë 15 ditësh, nga dita e hyrjes në fuqi të Vendimit, atëherë në përputhje me nenin 30, paragrafin 3 të Ligjit për Kundërvajtje, tatimpaguesi do të lirohet nga pagesa e 50% të shumës së gjobës së shqiptuar.*

Neni 3

Tek neni 17 i Rregullores bazë, ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 1, me tekstin si në vijim:

1. *Në qoftë se tatimpaguesi është i pakënaqur me Vendimin e ZGJONA-së, ai mund të paraqes ankesë në Divizionin e Ankesave për të rishqyrtuar atë përcaktim zyrtar të ATK-së.*

REPUBLIKA E KOSOVO
MINISTRIA E FINANCAVE
ADMINISTRATA TATIMORE
Zyra Qendro

Neni 4

Tek Shtojca 4, tek arsyetimi i vendimit në paragrafin e parafundit ndryshohet dhe plotësohet teksti si në vijim:

> ***Vërejtje:*** *Nëse pala e paguan gjobën brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e lëshimit të këtij Vendimi, shuma obligative për pagesë do të jetë 50% e shumës së përshkruar ne diapozitiv të këtij Vendimi.*

Neni 21
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe fillon të zbatohet nga data 01.01.2023.

Me datë 10/01/2023

zv. Drejtori Ekzekutiv i Administratës Tatimore
Ilir Murtezaj